



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

Nr 458 prot

Date 11 / 02 / 2022.

Lenda: Kthim Pergjigje.

Drejtuar: Znj. Nexhila Kodra, Pergjegjes Sektori i Keshillimit Ligjor dhe Monitorimit te Impakteve te Akteve Rregullatore, Ministria e Shendetesise e Mbrojtjes Sociale.

Znj. Albina Hoxhaj "INA" (Investigative Network Albania),

Rruga "Pjetër Budi" 69 Tiranë, Shqipëri

Ne pergjigje te shkreses Tuaj dt.26.12.2021 **Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion, dokumentacionit te "INA"** (Investigative Network Albania) referuar kerkesave Tuaja si me poshte;

- *A keni të dhëna se sa familje janë të pastreha në vend dhe kanë kërkuar ndihmë nga shteti shqiptar?*
Pergjigje: Ne Bashkine Permet rreth 80 familje jane paraqitur per te perfituar nga programet sociale te strehimit.
- *A janë strehuar nëpërmjet formave që parashikon ligji këto familje?*
Pergjigje; Ne Bashkine Permet aktualisht trajtohen me bonus qeraje sociale; 18 familje. Te strehuara ne banesat sociale jane 23 familje
- *Në rastet kur familjet në nevojë nuk i plotësojnë kushtet për të marrë kredi të zbutur, si procedohet, si ndihmohen?*
Pergjigje: Ne rast se aplikantet nuk permbushin kriteret per te perfituar nga programi per kredi te lehtesuara nga shteti, atehere ju jepet mundesia qe te aplikojne per tu trajtuar nga programet sociale te strehimit (bonus qeraje, banese sociale), sipas dokumentacionit te duhur ne baze te Ligjit nr.22/2018 "Per strehimin Social"
- *Gjatë këtij procesi a ka abuzime nga persona që janë në gjendje të mirë ekonomike?*
Pergjigje; Gjate ketij procesi nuk ka patur asnje rast abuzumi. Kriteret e perfitimit i jane referuar Ligjit 20/18 "Per strehimin" dhe Vendimeve ne zbatim te tij.
- *Keni ju si institucion sugjerime për ndryshime në procedura për të përfiturar nevojtarët dhe kufizuar abuzimet?*
Pergjigje: Referuar kerkesave per te perfituar sipas programeve sociale te strehimit duhet mbeshtetje financiare nga Ministria, pasi mundesite e Bashkise Permet jane te pakta.

Bashkia Permet mbetet e angazhuar per t'ju ardhur ne ndihme familjeve ne nevojë, sidomos kategorive te invalideve, persionist, grave te dhunuara, vajzave nena, komunitetit rom e egjyptian etj.

Duke ju falenderuar

KRYETARI I BASHKISE

ALMA HOXHA

